



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA VI**

**Sesioni Pranveror**

**Komisioni për Integrime Evropiane**

**Mbledhja nr. 38.**

**Prishtinë, më 12.02 2019 në orën 11:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302**

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE**

**Në mbledhje morën pjesë:** Blerta Deliu-Kodra, Armend Zemaj, Fikrim Damka, Ismajl Kurteshi, Fatmire Kollçaku, Zenun Pajaziti, Donika-Kadaj-Bujupi dhe Milaim Zeka.

**Mungoj:** Ismet Beqiri, Visar Ymeri dhe Adem Hoxha.

**Nga stafi mbështetës i komisionit:** Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

**I ftuar:** Ekrem Mustafa, ministër i Punëve të Brendshme, me bashkëpunëtorët.

**Mbledhjen e kryesoi;** Blerta Deliu Kodra, kryetare e komisionit.

**Kryetarja e Komisionit** pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen e komisionit me këtë;

**Rend dite:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 28.01.2019, 30.01.2019 dhe 31.01.2019;
3. Raportimi i z. Ekrem Mustafa, ministër i Punëve të Brendshme për zbatimin e Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit (PKZMSA) dhe Agjendës për Reforma Evropiane (ERA);
4. Shqyrtimi i raportit plotësues për Projektligjin nr.06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të ujit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Të ndryshme.

### **1. Miratimi i rendit të ditës.**

Rendi i ditës u miratua.

### **2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 28.01.2019, 30.01.2019 dhe 31.01.2019.**

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

### **3. Raportimi i z. Ekrem Mustafa, ministër i Punëve të Brendshme për zbatimin e Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit (PKZMSA) dhe Agjendës për Reforma Evropiane (ERA).**

**Kryetarja** falënderoi ministrin për prezencën dhe tha, kanë filluar përgatitjet për Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së për vitin 2019, si dhe për ERA -2, andaj ne si komision ju kemi ftuar që të na raportoni lidhur me përmbushjen e veprimeve nga ana e ministrisë të cilën ju e drejtoni për vitin 2018, në mënyrë që të shohim se cilat kanë qenë të arriturat dhe ngecjet në këtë drejtim dhe të mundohemi që me një bashkëpunim me të madh institucional të avancojmë rrugën tonë drejt përmbushjes së obligimeve tona.

Nga Raporti për vendin për vitin 2018, është thënë që është bërë pak progres sidomos në luftën ndaj terrorizmit, masat që janë kërkuar për përballjen me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin, si dhe në parandalimin e bashkimit të qytetarëve në konflikte të huaja.

Duke pas parasysh të gjitha obligimet të cilat janë të ndërlidhura me ministrinë të cilën ju e udhëhiqni, kërkojmë që të na raportoni se ku gjendeni në përmbushjen e këtyre obligimeve që i keni në kuadër të agjendës evropiane, si dhe cilat janë planet e juaja për këtë vit me qëllim të avancimit të punës së ministrisë.

**Ekrem Mustafa, ministër i Punëve të Brendshme** njoftoi se në kuadër të PKZMSA-së për vitin 2018, Ministria e Punëve të Brendshme ka planifikuar gjithsej 78 masa nga të cilat 9 janë masa legislative dhe 69 janë masa zbatuese.

Nga 9 masat legislative të planifikuara nga Ministria e Punëve të Brendshme në kuadër të PKZMSA-së për vitin 2018, 3 masa janë përfunduar, kurse 6 masa të tjera do të realizohen në fillim të këtij viti. Ndërsa nga 69 masat zbatuese të planifikuara, 54 masa janë përfunduar dhe 15 masa do të realizohen në fillim të këtij. Prej 69 masave zbatuese të planifikuara në kuadër të PKZMSA-së, 31 janë masa që adresohen në vazhdimësi dhe raportohen përmes të dhënave statistikore, andaj konsiderojmë se janë përmbushur. Nga 9 masat legislative të planifikuara nga Ministria e Punëve të Brendshme në kuadër të PKZMSA-së për vitin 2018, janë përfunduar 3 masa, ndërsa 6 masa do të realizohen në fillim të këtij viti.

Në fushën e menaxhimit të integruar të kufirit janë paraparë gjithsej 9 masa zbatuese, prej tyre 3 masa janë realizuar, ndërsa 6 masa do të realizohen në fillim të këtij viti.

Në fushën e vizave dhe sigurisë së dokumenteve janë paraparë gjithsej 6 masa, prej tyre 5 masa janë realizuar, ndërsa 1 masë do të realizohet në fillim të këtij viti.

Nga 27 masa të parapara në fushën e azilit dhe migracionit 23 masa janë zbatuar, ndërsa 4 masa do të realizohen në fillim të këtij viti.

Në fushën e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizimit 4 nga 4 masat e planifikuara janë përfunduar. Në fushën e luftës kundër narkotikëve 6 nga 6 masat e planifikuara janë përfunduar.

Në fushën e luftimit të krimit të organizuar dhe bashkëpunimi policor nga 8 masat e planifikuara, 6 masa janë përfunduar, ndërsa 2 masa do të realizohet në fillim të këtij viti.

Në fushën e luftimit të terrorizmit 4 nga 5 masat e planifikuara janë përfunduar.

**Kryetarja** pyeti ministrin, si është bashkëpunimi i ministrisë dhe përmbushja e obligimeve në raport me vizat, sa i përket procesit të ri integritetit. Në kemi pasur disa takime me ambasadorë të shteteve të akredituar në Republikën e Kosovës, të cilët e kanë përmendur se Kosova ka marrëveshje shtetërore me shumë shtete për proces të riintegritetit dhe riatdhesimit të shumë personave dhe kanë kërkuar një dinamikë më të shtuar që ne ta përmbushim edhe këtë objektiv. Kurse sa i përket migrimit është njëra prej temave më të përfolura dhe më aktive në forumet vendore dhe ndërkombëtare ku paraqet problem serioz të shteteve për t'u bërë anëtare e BE-së, na është kërkuar që ne ta vazhdojmë progresin në këtë drejtim.

Në vazhdim tha se pasi është hera e parë që ju kemi në komision pyetjen time do ta ndali tek rasti i fundit dhe bashkëpunimi që keni pasur me policinë dhe institucionet tjera sa i përket rastit të vajze së mitur nga Drenasi.

**Ministri** tha se sa i përket rastit mjaft shqetësues i cili ka ndodhur në Drenas e kam marrë me shumë seriozitet dhe e kam marrë si një rast që ka prekur 3 institucione shumë të rëndësishme, siç janë: Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit.

Kur e kamë kuptuar rastin, i kam ftuar në takim dhe kamë bashkëpunuar me gjithë aktorët të cilët duhet me qenë të involvuar në hetimin e këtij rasti dhe procesi i hetimeve të fillojë nga dita e parë kur vajza e ka denoncuar rastin, të hetohet personi, të hetohet procedura e hetuesisë në tërësi deri te momenti i tërheqjes së aktakuzës, të hetohet rasti i policit në fjalë që është i përfshirë në aktakuzë. Nuk do të thotë se do të ndërprehet zinxhiri i hetimeve aty ku ka mbetur, por kam kërkuar të merren masa ndaj institucionit në tërësi dhe do të jenë të informuar opinionit me kohë në hetimin e rastit.

Kam pasur takim edhe me Ministrin e Drejtësisë, Prokurorin e shtetit dhe drejtorin e policisë dhe kam kërkuar që sa më urgjent të realizohet dhe të vijë deri te dënimi i aktorëve të cilët janë të përfshirë në këtë rast të ndjeshëm.

**Kryetarja** pyeti se a do ta lëvizë ky rast kredibilitetin e institucionit më të rëndësishëm në vend siç është policia si institucioni më i besueshëm.

**Ministri** tha se sa i përket lëvizjes së besueshmërisë së qytetarëve në Policinë e Kosovës besoj që qytetarët tanë nuk do ta humbin besimin në këtë institucion, sepse mburrem se si është themeluar ky institucion dhe falë punës së shumicës së pjesëtarëve të policisë dhe agjencisë që i përkasin MPB, por sidoqoftë rasti në fjalë ndikon mjaft në kredibilitetin dhe besueshmërinë, por nëse e hetojmë rastin në mënyrë adekuate dhe e merr epilogun e duhur nuk do të ndikojë në besueshmërinë e policisë.

**Armend Zemaj** tha se është e vërtetë se MSA nuk po përmbushet në Republikën e Kosovës dhe as tani ERA-2 dhe kjo është mangësi kolektive dhe duhet të jetë një fokus më i veçantë i grupeve që e bëjnë punën në përditshmëri dhe mos të merremi vetëm me skandale të prodhuara, qofshin ditore dhe ato të së kaluarës.

Në aspektin e mbikëqyrjes politike, Policia e Kosovës është ka lëndohet në shumë aspekte, në aspektin e ndërhyrjeve direkte politike ju duhet mos të lejoni dhe agjencive tjera që janë të pa varura nën mandatin e juaj si ministri e brendshme, sepse kemi pa

interferime të vazhdueshme duke filluar prej shkarkimit të kryeshefit, mos kthimit të tij dhe tani zgjedhja tjetër dhe kjo tani e cila ka krijuar edhe raportin tjetër me Policinë e Kosovës duke futur dualizma siç ishte raporti mes AKI-së dhe policisë ku për vite të tëra e kishim një luftë ndërmjet tyre dhe aspekti i sigurisë në Kosovë lëndohej në vazhdimësi dhe prodhohen skandale tjera në vazhdimësi. Këta njerëz nuk dënohen por avancohen, e dini avancimin e fundit për tenderin kriminal të pasaportave, ku në vend se të degradohen ata njerëz marrin pozita udhëheqëse.

Ne momentin që gjendemi, ju ministër duhet të jeni më këmbëngulës edhe në rastin e fundit që e përmendem, por ka pak shpresë për mënyrën se si po menaxhohen situatat.

Para disa ditësh ishte në media shkarkimi i një polici i cili kishte mirënjohje për punën efektive që ka bërë në luftimin e dukurive negative në Policinë e Kosovës. Një polic hetues, rastet të cilat -qoftë në luftimin e narkotikëve, krimin dhe korrupsionit, siç ishte zërja në flagrancë e zv. ministrit për korrupsion, apo rastet të zyrtarëve komunal të Gjilanit dhe i njëjti polic degradohet në pozitë periferike në raport me punën e bërë disa vjeçare. Pyetja ime është se pse po ndodh kjo tani, a është ndërhyrje politike, apo ndërhyrje e grupeve të interesit për t'ju mundësuar grupeve kriminale në Kosovë që ta shtrijnë aktivitetin e tyre të kriminit të organizuar dhe grupeve të interesit. Pyetja tjetër, sa polic i keni nën hetime që janë pjesë aktive në udhëheqjen e strukturave policore dhe cili është fati i rastit të hetimeve të një grupi të policëve të cilët kanë marrë dhe marrin pension invalidor dhe janë pjesë e policisë së Kosovës. Mendoj se pa luftimin e këtyre dukurive policia e Kosovës nuk do të lejohet të zhvillohet, edhe pse aty ka njerëz me kredibilitet dhe tentojnë dhe mundohen ta bëjnë punën ndershëm dhe t'i eliminojnë defektet dhe rastet e mëdha që ka ndodhur brenda policisë dhe nuk mund pa e përmend vjedhjen në dhomën e dëshmimeve dhe as një herë as një ministër nuk ka dhënë asnjë përgjegjësi dhe pasojat e udhëheqjes së këtyre individëve, Kosova nuk po ec në pjesën integrale. Si anëtar dhe deputet i shpreh shqetësimet e mia, por gjithmonë duke respektuar mandatin e juaj të ri, por duke shpresuar dhe besuar që në këtë fazë që jemi dhe mundësitë dhe kapacitetet që i posedoni ti, përmirësoni dhe avancojnë punët e mira brenda MPB-ës dhe brenda institucioneve dhe agjencive të sigurisë.

**Donika Kadaj** tha se mendoj që ministri nuk mund të japë përgjigje për zhvillimet që kanë ndodhur në vitin 2012 dhe as dhomën e dëshmimeve, sepse nuk mund të marrë përgjegjësi për para ardhësit e vet. Tani po kthehem te pyetjet konkrete të zhvillimeve të fundit, kam vazhdimisht pyetje nga bashkatdhetarët tanë, sidomos që jetojnë në Gjermani, lidhur me patentë shoferët dhe disa herë ka qenë në media temë se jemi në një marrëveshje reciproke, a mund të na njoftoni se në cilën fazë jemi dhe çka po ndërmerrni në këtë drejtim, në mënyrë që qytetarëve me ju lehtësuar njohja e këtij dokumentacioni dhe shfrytëzimi i tyre në Gjermani, sepse atje kushton shtrenjtë ripërsëritja e orëve shtesë dhe testit dhe gjuha po është problem. Përveç Gjermanisë, a keni filluar procedurë për marrëveshje edhe me shtetet tjera dhe në cilën fazë jeni.

**Ismajl Kurteshi** tha se kishte disa pyetje konkrete

Duke pasur parasysh se nuk po janë raste të rralla kur policët në vend se ta luftojnë krimin, shpesh ata po janë pjesë e kriminit, andaj a mendoni se është i nevojshëm një Veting i brendshëm brenda policisë në mënyrë që të pastrohet policia dhe të krijohen kushte që të luftohet krimi.

Integrimi evropian po pengohet për arsye të korrupsionit të lartë dhe kriminit të organizuar, rezultatet e luftës kundër kriminit dhe korrupsionit janë të pa mjaftueshme për BE-në, prandaj ka ndodhur shtyrja e liberalizimit të vizave, çka keni planifikuar të

ndërmerrni që rezultatet e luftës kundër krimit, korrupsionit, narkotikëve dhe veprimeve tjera të arrijnë rezultate të duhura dhe mos të ndodhë që brenda ditës të plaçkiten 2-3 banka dhe ato të lëvizin lirshëm.

Cilat janë lidhjet me policinë e rajonit, me cilin vend bashkëpunoni më shumë dhe sa e pengon dështimi i pranimit të Policisë së Kosovës në INTERPOL.

Lidhur me dhomën e dëshmimeve, a është mbyllur rasti apo hetimet po vazhdojnë. Kanë kaluar 20 vite dhe ne prodhojmë policë që shkollohen me kurse. A planifikoni t'i shkolloni policët në shkollë të mesme 3 vite dhe të ndërpritet kjo formë e angazhimit në polici bazuar në lidhjet politike dhe familjare.

**Zenun Pajaziti** tha se nuk ka dyshim se ky rasti i fundit i ka qitur në hije shumë punë të mira që i bënë kjo ministri edhe shumë sfida dhe punë që duhet me u krye.

Pyetja ime është se në fushëveprimin e juaj, cilat janë sfidat më të rënda që ju i keni në agjendë dhe me e gjetur mënyrën se çka mund të ndihmojmë ne, si deputetë në këtë drejtim në përgjegjësit që i kemi në monitorimit të zbatim të ligjit.

Pyetja ime është, kërkoj të njoftoni lidhur me Agjencinë e regjistrimit civil i cili është një prej fushave që ka të bëjë me sigurinë e dokumenteve, ju keni nënshkrua një dokument i cili avancoi pavarësimin e kësaj agjencie, në konceptin e ri është krijuar një agjenci me përgjegjësi goxha të pa varura, por a është fjala tani për një agjenci që do të jetë krejt i pa varur prej MPB, apo si kur janë agjencitë tjera. Në brenda kemi bërë debat për me zvogëluar numrin e agjencive, sepse shumë herë duke menduar me i pavarësuar kemi bërë shumë burokraci dhe shumë shpenzime të buxhetit, nuk është vetëm te ana e buxhetit, por duhet të kemi një arsyetim nga ana e institucioneve në një vlerësim më shumë se e kostos financiare se a duhet apo jo një agjenci brenda kësaj ministrie.

**Milaim Zeka** tha se do të ishte mirë ministër që pa prezencën e mediave të diskutojmë, sepse kur po janë mediat, po bëhen spektakle dhe ne deputetët po duhet të jemi më të rezervuar në diskutime..

Fillimisht LDK-ja e kanë pasur Ministrinë e Punëve të Brendshme për disa vite, kështu që përgjegjësin më të madhe për Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme e bartë LDK-ja me PDK- në sepse kanë qenë në koalicion.

Sa i përket dhomës së dëshmimeve, ajo çka mua më shqetëson është se kjo ka qenë përgjegjësi absolute e UNMIK-ut dhe e EULEX-it, i cili ka pas filluar një hetim dhe unë kur kam qenë gazetar kam publikuar një dokument sekret, dhe në mesin e njerëzve i cili ka qenë i dyshuar është një zyrtar i lartë i policisë . Sa i përket rastit të fundit në Drenas, mua me vije turp që jam deputet, imagjinoi sa raste të pedofilisë i ka kisha katolike, pastaj sa raste zbulohen çdo ditë në shtetet e perëndimit dhe nuk kam dëgjuar që në botën perëndimore mblidhet Parlamenti për seancë të jashtëzakonshme dhe debaton një rast të shëmtuar dhe të dënueshëm për çdo njeri, por jo në përmasa që Parlamenti i Kosovës debaton dhe ia qet faqen e zezë Kosovës me atë seance të jashtëzakonshme.

Ne kemi mundur me thirr seancë të jashtëzakonshme rreth procedurave hetimore që i bëjnë disa hetues të policisë së Kosovës. Unë po e shoh që në këtë vend ekziston një mungesë e vullnetit për me u bërë një spastrim brenda policisë së Kosovës, brenda sektorëve të hetuesve.

Dikush tha se duhet të hapet Vetingu, mendoj se është momenti më i duhur që të bashkëpunohet me AKI-në dhe grupi i policëve hetues të kalojë nëpër sitën e Vetingu.

Unë z. ministër ju jap mbështetje absolute në punën tuaj dhe kisha pasur dëshirë që pa prezencën e mediave të bisedojmë për gjërat konkrete të cilat unë i di që mendoj se do t'i shërbejnë policisë.

Megjithatë ju inkurajoj sepse policia e Kosovës është model i mirë për Ballkanin.

**Fatmire Kollçaku** tha se është vështirë që krejt çështjet me ju adresuar juve ministër, sepse po e ushtroni për një kohë të shkurtër postin, mirëpo dashtë e pa dashtë prej të gjithë deputetëve u prek ky rasti i fundit, ajo seancë që u mbajt, nuk është që ta anatemojmë policinë e Kosovës, por pikërisht për ta kthyer besimin te qytetarët duke dashtë me ditur se a është rast i izoluar apo dukuri. Tashmë janë bërë shumë afera dhe mos t'i kthehemi tani aferave të mëparshme, por është obligim i çdo Qeverie të kujdeset se a ka zyrtarë që kanë qenë të përfshirë në këto afere dhe a vazhdojnë të ushtrojnë poste të rëndësishme në polici.

Dëshirojmë të dimë se a kujdeseni për familjet që policët e kanë humbur jetën gjatë punës dhe për policët që janë lënduar në punë, sepse nuk e kemi ende sigurimin shëndetësor publik, sepse si shoqëri kujdesemi për pushtetar, e jo për policët që e kanë dhënë jetën duke kryer me nder detyrën. U përmend riatdhesimi, çka po boni ju për këta njerëz më tutje, a po përkujdesemi për këta njerëz që e lëshuan këtë vend për shumë shkaqe, si ekonomike dhe çështje të diskriminimit. Ne ju kemi ftuar të diskutojmë për shumë çështje të rëndësishme, prandaj ne duam të dimë se konkret çka po ndërmerret, sepse nuk mjafton që vetëm të prodhojmë dokumente dhe pastaj të çalojmë në zbatimin e tyre. Kam lexuar në media se 94 policë kanë qenë të përfshirë në afere të ndryshme dhe 12 prej tyre janë gjykuar dhe kanë dalë të fajshëm, ndërsa kemi raste kur fëmijët e pushtetarëve, nxehen qoftë me droga qoftë me armë dhe pastaj është bërë shumë problem se kush e ka plasuar këtë informatë dhe hetuesia nuk është marrë me rastin, por me atë që e ka plasuar informatën.

Keqpërdorimi i detyrës zyrtare është për çdo rast është i dënueshëm, sepse për të qenë pjesë e BE-së, ata nuk e shikojnë vetëm miratimin e ligjeve, por edhe kredibilitetin e institucioneve.

Me njësitin antidrogë, çfarë po bëhet në këtë drejtim, është mirë të fuqizohet ky njësitë dhe t'u jepet përkrahje më e madhe sepse sa më afër qytetarit do të rritet besueshmëria ndaj zyrtarëve tuaj. Pikënisja e rikthimit të besimit të qytetarëve fillon nga institucioni që ju e udhëhoqni ministër dhe bartni një përgjegjësi të madhe. Duhet të kemi njësitë të specializuara sidomos në hetuesi dhe në rastet kur merren në pyetje të miturit, të mos intervistohen pa prezencën e prindit dhe punëtorit social, prandaj nëse i qasemi si duhet këtij rasti dhe nëse vërtetohet fajësia dhe të involvuarit në këtë krim do ta marrinë përgjigjen e duhur nga drejtësia atëherë mendoj se dhunuesit tjerë në krim do të mendohen dy herë para se të involvohen në ndonjë krim të ngjashëm.

**Fikrim Damka** lidhur me inkuadrimin e komuniteteve në Policinë e Kosovës tha, në rastin e fundit të konkursit për pranimin e 300 policëve, ne kemi bërë përpjekje të inkuadrojmë edhe nga pjesëtarët e komunitetit turk, por nuk kemi parë një vullnet nga policia e Kosovës. Duhet ta sqarojmë një çështje, se nëse komuniteti turk ka të drejtë shkollimi në gjuhën e vet amtare, atëherë edhe testet duhet t'i ketë në gjuhën e vet në provim pranues dhe ky ka qenë diskriminim sepse keni hap konkurse edhe në Prizren, ku gjuhë zyrtare është gjuha turke. Andaj për vitin 2019 do të keni prapë konkurs të keni parasysh këtë.

Pastaj ka diskriminime të gradat, sidomos në Prizren, kemi keqpërdorim të komuniteteve, ku i zënë vendin komuniteteve në punësim. Pastaj kemi raste ku i

kryejnë të rinjtë tanë akademinë 4 vjeçare ne vendet e rajonit dhe kur të kthehen prapë ai duhet me hy në test dhe nëse e kalon testin e parë me krye në Vushtrri 7 muaj akademi.

Disa herë kemi ngritur edhe çështjen e fitimit të shtetësisë së Kosovës, kemi kërkesa të mëdha nga njerëzit tonë që jetojnë në Turqi, të cilët kanë lindur në Kosovë, por për shkak të burokracisë dhe kërimit të tepërt të dokumenteve jashtë ligjeve dhe me udhëzime administrative që kalojnë kompetencat e ligjeve kërkohen dokumente të tepërta dhe ky është shqetësim.

Ne fund tha kërkoj që zyrtarëve policor t'u jepet mundësia që së paku namazin e xhumasë ta falin gjatë orarit të punës.

**Kryetarja** lidhur me zbatimin e Planit Kombëtar të MSA-së tha se ne raportin që kemi marrë thuhet se ka vonesa të vogla në miratimin e strategjisë për migrim dhe menagjimin e integruar të kufirit, çka po bon ministria juaj që kjo strategji të miratohet.

Po ashtu ka vështirësi të mëdha për miratimin e strategjisë për narkotikët 2019-2023 dhe strategjinë kundër krimit të organizuar, të gjitha këto strategji MPB duhet t'i marrë në konsideratë për të përmbushur zbatimin e PKMSA.

**Ministri**, lidhur me pyetjen për ndërhyrjet politike tha: ju garantoj se ndërhyrje politike nuk ka dhe nuk do të ketë kurrë sa të jem në këtë detyrë.

Lidhur me pyetjen për marrëveshjet për pranimin e patentë shoferëve për bashkëatdhetarët tonë që jetojnë ne diasporë tha se ne kemi rinisur procedurën për pranimin e patentë shoferëve me Italinë, Zvicrën, Kroacinë, Sllovenin dhe në përfundim e kemi me Gjermanin dhe e ambasada e Kosovës në Gjermani na ka njoftuar që është ne përfundim edhe shteti Gjerman, në Francë na pranohet patentë shoferi por nuk kemi marrëveshje, kemi marrëveshje të nënshkruar me Shqipërinë dhe Maqedoninë, kurse pritet që së shpejti të lidhet edhe me Malin e Zi.

Lidhur me pyetjen e bërë për Vetingun tha se e kena propozua dhe adresuar te AKI, por ata me një rekomandim na kanë thënë se nuk kamë efektiv me e krye këtë, kemi propozuar që me i çua pjesë-pjesë dokumentacionin e pjesëtarëve të policisë dhe Vetingu të fillohet nga brenda institucioneve policore, sepse edhe unë i kam dyshimet e mija që shumë zyrtarë policorë gjinden në vende të pa dëshiruara dhe kryejnë punë të pa dëshiruara.

Kurse për policët që janë nën procedurën e hetimeve në prokurori dhe marrin pensionin invalidor ia jap fjalën zyrtarit policor të jap përgjigje.

**Riza Shillova, drejtor në Departamentin e Hetimeve** tha se rasti i fundit në Drenas e ka cenuar integritetin në përgjithësi, por kjo nuk nënkupton që policia do të zbrapset nga përmbushja e obligimeve dhe përgjegjësit që ka. Ne në vazhdimësi identifikojmë dhe hetojmë rastet e shkeljeve të zyrtarëve policorë, ne gjatë vitit 2018 kemi trajtuar 830 raste, në progres janë edhe 238 lëndë, kemi pasur 311 masa disiplinore të shqiptuara dhe 26 raste të ndërprerjes marrëdhënies së punës.

Ne jemi për t'i verifikuar të gjithë zyrtarët policor, por sidomos ata që punojnë në hetime sepse neve na nevojiten zyrtar me kredibilitet dhe integritet, por më vije keq kur dëgjoj këtu dhe nga mediat, kinse ndonjë zyrtar policor largohet për ndonjë hetim, në fakt nuk qëndrojnë këto konstatime, ne nuk mundemi me i bërë publike të gjitha vendimet për transfere, sepse neve na duhen zyrtar me rezultate dhe iniciativa jonë ka qenë në ngritje të kapaciteteve në këtë drejtim për të pasur rezultate më të mira, ne kemi edhe iniciativa tjera, kemi vendos ta themelojmë një sektor për integritet dhe

konflikt interesi që do të ketë shtrirje nëpër rajone dhe kjo do të na japi mundësi që ne në mënyrë proaktive të kemi informacione të përgjithshme para se me ardhur rasti.

**Armend Zemaj:** Jo rastësisht i përmenda konfliktet në të kaluarën, sepse ne informohemi prej mediave dhe i konsideroj kredibile, e kam pak të pa qartë z. drejtor sepse nga ajo që kam parë dhe kam lexuar në rastin që e përmenda të hetuesi policor, gradimi i tij dhe avancimi i tij ka qenë me sugjerimin e juaj duke marrë për bazë hetimin dhe luftimin e krimit me narkotikë që personi në fjalë e ka zhvilluar, pas kalimit në njësitin tjetër ka arritur rezultate ku ka kapur zyrtar qeveritar në vepra korruptive dhe për këtë arsye më erdhi çudi pse një njeri i tillë degradohet në pozitë periferike ku ka pasur rezultate të mëdha në luftimin e krimit dhe korrupsionit, andaj më ndihmo ta kem të qartë me e kuptuar pavarësisht pjesëve konfidenciale.

**Riza Shillova** nuk është degradim, nëse një zyrtar lëviz prej një njësie në njësinë tjetër, janë nivele të njëjta, pajtohem se në fushën e trafikimit me narkotik kemi pasur rezultate dhe nuk i atribuohet një zyrtari, sepse ka edhe 100 tjerë, por nuk kemi pas rezultate në fushën e luftimit të krimit ekonomik dhe korrupsionit, nuk është e vërtetë që është larguar zyrtari që e ka plasuar lajmin në media, nuk e kuptoj se si një medium mirët me transferin e vetëm një zyrtari.

Lidhur me korrupsionin, ai tha se ka korrupsion të zyrtarët e lartë, nëse në raport i shohim statistikën dhe të dhënat e përgjithshme të luftimit të krimit, gjatë vitit 2018 kemi hetuar 2419 raste në total dhe krahasuar me vitet tjera është në rritje për 14%, kemi rezultate në hetimet e krimit me narkotik, por kemi rezultat të ultë, në hetimin e krimit ekonomik dhe keqpërdorimin e detyrës zyrtare dhe kundër pasurisë. Ne po i bëjmë reformat me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe besoj që rezultatet do të shihen vitin e ardhshëm, jo vetëm policia, por duhet të angazhohen edhe institucionet tjera.

Kemi pasur progres në fushën e luftimit të terrorizmit, trafikimin me qeniet njerëzore dhe fushat tjera.

**Ministri** lidhur me dhomën e dëshmitarëve tha se është në procedurë të hetimeve, kurse sa i përket shkollimit të policëve, akademia publike në Kosovë është në riorganizim, pranimi i policëve sipas konkursit është 6 muaj trajnim për ata të cilët e kanë kaluar testin dhe kjo ju mundëson inkuadrimit në policinë e Kosovës.

**Ismajl Kurteshi** pyeti ministrin se a kanë ndonjë plan me bërë tamam shkollë.

**Ministri** tha se vetë akademia në Vushtri është në riorganizim të saj. Trajnimi i policisë në fakt zgjat dy vite dhe tani gjenerata e re, e cila është në trajnim është në bazë të një programi të ri, i cili është dizajnuar së bashku me Akademinë Kosovare për siguri publike, është një program që është kreditua dhe është me një standard të BE-së.

Lidhur me pyetjen për bashkëpunimin ndër policor, tha se ka bashkëpunim në nivel agjencish, agjencia e forenzikës ka bashkëpunim me agjencinë e forenzikës Kroate, Irlandezë dhe Italiane, ka bashkëpunim ndër policor me Italin dhe e kemi afër nënshkrimin e marrëveshjes, i kam bërë ftesë zyrtare ministrit të Punëve të Brendshme me e nënshkruar, e kemi nënshkruar marrëveshjen edhe me Maqedoninë në kuadër të bashkëpunimit të brendshëm.

Kurse lidhur me pyetjen për Agjencinë për regjistrim civil dhe vendimin që e kam nënshkruar ka qenë një shqetësim prej ditëve të para kur e kam marrë detyrën dhe nuk kam pasur njohuri për këtë, jam konsultuar me kryeministrin, ky institucion këtë vit ka pasur të hyra buxhetore që kanë kontribuar në buxhetin e Kosovës për 53mil€ agjencia i ka rreth 670 punëtorë dhe është i ndërlidhur direkt me MPB, përpos,



financave , logjistikës dhe resurseve humane që i menaxhon vetë. Kurse sa i përket ligjit jam në konsultime me zyrën ligjore dhe po e presim vendimin e Ministrisë së Administratës Publike.

**Milaim Zeka** i tha z. Shillova se është i lumtur që ai e udhëheq Departamentin e Hetimeve, por tha se me shkuar pak më poshtë keni pasur njerëz të cilët i kanë udhëhequr krimet serioze e që kanë qenë me një piramid krimesh, por nuk është faji i policisë dhe për hir të informimit të drejtë të publikut ka raste kur policët për një vit punojnë në një rast dhe një prokuror del dhe ia gjuan komplet punën e policisë dhe ky është problem serioz.

Te rasti i Karaxhës për mua tha është shqetësuese se kush e dha informatën te gazetarët, kush ka hyrë në kompjuter dhe ky duhet të jetë shqetësim i madh për policinë. Kam dëgjuar nga një vajzë e cila është kandidatë për police, e cila i ka dhënë të gjitha provimet me sukses dhe dikur ia shkruajnë një letër dhe i thonë se në vitet 70-ta babai yt i ka vrarë dy njerëz dhe për shkak nuk jeni pranuar . A mund të jetë kjo një argument, por sido qoftë ju inkurajoj me futur Vetëpunëtorin në Polici dhe Parlament.

**Riza Shillova** për rastin Karaxha tha se nuk ka informacione për me dhënë më shumë sepse nuk e kemi askënd këtu nga inspektorati policor, por sa i përket verifikimit të së kaluarës kryhet nga mekanizmat profesionalë në kuadër të Policisë dhe nuk kam informacion konkret për rastin që e përmendet nuk kam informacione, por sidoqoftë e kemi komisionin e brendshëm që i rishikon ankesat dhe do ta shqyrtojmë cila është arsyeja.

**Fatmire Kollçaku** ne pritem që do jeni më tepër autokritik dhe të na i paraqitni sfidat me të cilin do të ballafaqoheni dhe ne të shohim si deputetë ku do t' ju kishim mbështetur rreth sfidave me te cilat ballafaqoheni e jo te arriturat, sepse në Raportin për vendin në fushën e sigurisë, drejtësisë dhe në luftën kundër krimit ka pak progres.

**Ministri** lidhur me pyetjen për përkujdesjen e familjeve të policëve që kanë humbur jetën ne detyrë, si objektiv tha e kam që gjatë pjesës së parë të këtij viti t'ia paraqes ministrisë se financave draftin sa i përket sigurimit të jetës dhe sigurimet shëndetësore me një kosto që do t'i mbulojë 50 mi-€ nëse polici e humb jetën, kurse 30 mi € shpenzime shëndetësore, ku 50% do të paguan polici dhe 50% punëdhënësi, ndërsa sa i përket policëve të cilët e kanë humbur jetën ata kanë një mbikëqyrje prej 70% të pagës që ju jepet familjarëve të policit që e ka humbur jetën.

Lidhur me pyetjen për riatdhësim ia dha fjalën bashkëpunëtorit të tij për riatdhësim. Ai tha se sa i përket ripranimit i kemi 22 marrëveshje me 22 shtete dhe të gjitha janë duke u zbatuar, kurse sa i përket ri integritit në shoqërinë kosovare ne e kemi departamentin për riintegrim dhe është mirë duke funksionuar. Ai njoftoi për strategjinë e riintegritit e cila do të jetë e gatshme në pjesën e dytë të këtij viti dhe është duke u hartuar me ekspert ndërkombëtar kryesisht ka të bëjë me migrimin e rregullt dhe migrimin e pa rregullt.

Kurse sa i përket aspektit të shtetësisë, zyrtarët tanë tanë janë duke e zbatuar Ligjin dhe udhëzimet administrative dhe kemi komisionin e shkallës së dytë për t'i shqyrtuar ankesat nëse bëjnë gabime zyrtarët tonë.

**Fatmire Kollçaku:** Sa i përket sigurimeve shëndetësore unë angazhohem për sigurim publik për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe të gjithë duhet të angazhohemi që të zbatohet Ligji për shërbimet shëndetësore , ndërsa sigurimet private në të shumtën e rasteve e ndalin sigurimin në momentin kur dikush sëmuret sepse, e kanë monopolin.

Nëse vendosni për sigurime shëndetësore private kërkon nga kompanitë me lidhur kontrata një vjeçare dhe polici me qenë i shëndoshë, por në momentin kur polici do të jetë i lënduar dhe do të ketë nevojë për shërbime shëndetësore afatgjate mundet me ndodhur që kompania mos t'ia ripërtërijë kontratën në vitin pasues. Ju duhet të kërkon që të siguroheni se nuk do të dëmtohet polici i cili do të pësojë aksident dhe do të ketë nevojë afatgjate për trajtim. Për këtë arsye duhet të mundohemi i për sigurime publike.

Ministri konsideron se këtu nuk kemi të bëjmë me kontratë individuale, por kontratë kolektive dhe ka të bëjë me një marrëveshje e cila nuk firmoset pa e përpiluar në mënyrën se si i konvenon Policisë së Kosovës. Kurse lidhur me intervizitimin e fëmijëve me prezencën e prindërve tha do të jetë me prioritet të rëndësishëm. Lidhur me konkursin në Policinë e Kosovës dhe pranimin e komuniteteve, ne kemi diskutuar për këto probleme edhe në zyrën time dhe interferimi im në konkurs ka qenë i pa mundur, në bisedën që kemi pasur e kam adresuar problemin se testi në Prizren është dashtë të jetë në gjuhën turke që ta ketë më lehtë në gjuhën e vet, është shqetësim i të gjitha komuniteteve. Kurse për faljen e namazit ne nuk e ndalojmë askënd, por ka të bëjë me respektimin e orarit të punës dhe polici është në detyrë gjatë gjithë kohës.

Në fund lidhur me rastin në Drenas tha jemi duke u angazhuar në maksimum që ta merr epilogun e duhur dhe personi ta marrë dënimin e merituar.

**Kryetarja** pas diskutimeve falënderoj ministrin me bashkëpunëtorët për korrektësi në raportim dhe përgjigje në pyetje dhe vazhdoj me pikën e radhës.

#### **4. Shqyrtimi i raportit plotësues për Projektligjin nr.06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të ujit , me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.**

**Kryetarja** tha se sa i përket këtij projektligji ne, më 18 dhjetor 2018, kemi shqyrtuar Projektligjin dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, ndërsa sot kemi një raport plotësues lidhur me këtë projektligj.

Lidhur me këto amendamente konstatoj se fushë-veprimtaria e projektligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit nuk është në kundërshtim me legjislacion të BE-së, rrjedhimisht edhe këto amendamentet të propozuar nga Komisioni FunkSIONAL nuk janë në kundërshtim me legjislacion të BE-së.

Hap diskutimin dhe pastaj e hodhi në votim.

Pas votimit kryetarja konstatoj se komisioni me shumicë votash nxori këtë;

#### **Rekomandim**

**Raportit plotësues për Projektligjin nr.06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të ujit, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.**

Mbledhja përfundoi në orën 16:15.

**Përgatitur nga**

**Njësia për mbështetjen e komisionit**

**Kryetare e komisionit,**

-----

**Blerta Deliu-Kodra**